

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.  
ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. 167/15 prot

Datë 12.04.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

Drejtuar: **"ELEKTRO THERM" Sh.p.k, adresa: Objekt Privat, Rruga Eordej, Rruga Korçë - Bilisht, Km I, Korçë.**

Procedura e prokurimit/lotit: **"Procedurë e hapur e thjeshtuar" me mjete elektronike**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-99227-03-25-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]: **"Blerje tubo për rrjetin e kanalizimeve", me kohëzgjatje 30 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] : **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 17 datë 2 Prill 2024.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "DOKSANI - G" Sh.p.k, NIPT: L21809501H, vlera: 1497300 (njëmilionekatërqinde nëntëdhjetëeshtatë mijëetreqind) lekë.
2. "ELEKTRO THERM" Sh.p.k, NIPT : L43709006U, vlera: 1656000 (njëmilione gjashtëqinde pesëdhjetëegjashtëmijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "DOKSANI - G" Sh.p.k, NIPT: L21809501H.

Për arsyet e mëposhtme:

➤ Në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, nenin 82, pika 2, KVO unanimisht vendosi që ofertuesi "DOKSANI - G" Sh.p.k, NIPT: L21809501H , të mos kualifikohet sepse:

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 2.2.2, Shtojca 7 e DT, për arsye se nuk paraqiti mostra për tubot e ofruara.
  
2. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 2.2.3, Shtojca 7 e DT, lidhur me tubot e brinjëzuara, për arsye se sipas katalog teknik të firmës "TEQJA INTERNACIONAL" Sh.a, të paraqitur nga ofertuesi rezulton që:
  - Tubot PE SN4 kanë diametër të jashtëm 200mm, ndërsa diametri i brendshëm është 178 mm , duke mos përmbushur kërkesën e AK që kërkon tubo PE SN4 me diametër të brendshëm 200mm ( ± 2%), me diferencë pra 11 % nga diametri i kërkuar;
  - tubot PE SN4 me diametër të brendshëm 300mm ( ± 2%) nuk paraqiten fare;
  - Tubot PE SN8 kanë diametër të jashtëm DN 500mm, ndërsa diametri i brendshëm është 438 mm , duke mos përmbushur kërkesën e AK që kërkon tubo PE SN8 me diametër të brendshëm 500mm ( ± 2%), me diferencë pra 12,4 % nga diametri i kërkuar;
  - Tubot PE SN8 kanë diametër të jashtëm DN 200mm, ndërsa diametri i brendshëm është 178 mm , duke mos përmbushur kërkesën e AK që kërkon tubo PE SN8 me diametër të brendshëm 200mm ( ± 2%), me diferencë pra 11 % nga diametri i kërkuar.

Pra katalogu i paraqitur dëshmon se tubot e ofruara si me sipër nuk kanë diametër të brendshëm sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "ELEKTRO THERM" Sh.p.k, adresa: Objekt Privat, Rruga Eordej, Rruga Korçë - Bilisht, Km I, Korçë, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej 1656000 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

**Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor**  
**Pandi Qirinxhi**